VENDIM
Nr. 171, datë 28.12.2012

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE ME PËRSËRITËS "CRI RADIO E JASHTME E KINËS" SUBJEKTIT: SHOQËRIA "ALB-CRTV" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe rregullores "Për licencimin e operatorëve për transmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio me përsëritës", miratuar me vendimin nr. 26, datë 23.10.2000, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "ALB-CRTV" sh.p.k., për t'u licencuar si operator radiofonik privat me përsëritës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "ALB-CRTV" sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat me përsëritës, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati